



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.16, datë 9.10.2019

PËR  
DHËNIE PËLQIMI PËR MIRATIMIN E VAZHDMIT TË PROCEDURËS  
KONKURUESE SË DHËNIES ME QIRA ME AFAT 5 VJEÇAR PËR OBJEKTIN,  
“NJËSIA THERTORES (PRERJE BAGETIVE)”, NDODHUR NË ZK 1495,  
DOBRAÇ-NJËSIA ADMINISTRATIVE RRETHINA, BASHKIA SHKODËR ME  
SIPËRFAQË TOTALE 1131 m<sup>2</sup>, (NGA KU 425 m<sup>2</sup> OBJEKT, 706 m<sup>2</sup>  
TRUALL/SHESH FUNKSIONAL), NË PASURINË NR.152/2.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 9.10.2019, mbështetur në Ligjin nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, shkronja ‘e/1’, neni 55, pika 3; Ligjin nr.10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr.230 dt.20.03.2013 “Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standarteve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore”; VKM nr.54 dt.05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, te procedurës e te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shtetore”, te ndryshuar; Udhëzimi nr. 13 datë 26.04.2018 “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014”, Udhëzimi nr.30, dt.27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar, relacionit të përgatitur nga administrata e bashkisë Shkodër.

V E N D O S I


1. Të miratoj dhënie pëlqimi, për miratimin e vazhdimit të dhenies me qira(procedurë konkurrese) me afat 5 vjeçar për objektin, “Njësia Thertores (therje e kafshëve)”, ndodhur në ZK 1495, Dobrac-Njësia Administrative Rrethina, bashkia Shkodër me sipërfaqe totale 1131 m<sup>2</sup>, (nga ku 425 m<sup>2</sup> objekt, 706 m<sup>2</sup> truall/shesh funksional), në pasurinë nr.152/2, sipas gen-planit bashkelidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretar i këshillit

Denis Lesha



# PLANIMETRIA E VENDOSJES



152/2


TREGU ME SHUMICE FRUTA - PERIME



MIRATOHET  
KRYETARI I BASHKISË  
VOLTANA ADEMI



SH 1: 5000



OBJEKTI	NJESIA E THERTORES ( PRERJE BAGETIVE )	
GJENDJA	Truall + Ndertese	Sip. Truall/ shesh 706 m2 Sip. Ndertimore 425 m2
Per Drejtorine Juridike Sektori i Aseteve	Punoi ;	
Inxh. Lulzim Mashi	Inxh. Lulzim Mashi	
	Bashkia Shkoder	
	SH 1 : 500	